

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 E martë, 9 janar 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.32

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi dhe mirë se keni ardhur pas pushimit dimëror të  
7 Gjykatës.

8 Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar  
10 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-04, Prokurori i  
11 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Fillimisht, u lutem të pranishmëve të prezantohen. E  
15 fillojmë me ZPS-së.

16 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.  
17 Për ZPS-në Line Pedersen, Federica Genovesi, Eva Wyler,  
18 Filippo De Menicis dhe unë, Gaia Pergolo.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Mbrojtës i Viktimave, keni fjalën.

22 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar Gjykatës.  
23 Jam Simon Laws, Mbrojtësi i Viktimave në këtë çështje  
24 gjyqësore së bashku me bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 Faleminderit.

2 Tani Mbrojtja.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim]. Faleminderit. Unë jam Jean-Louis  
4 Gilissen. Jemi këtu së bashku me z. Shala, i cili na ndjek nga  
5 qendra e paraburgimit. Këtu jemi me z. Aouini, znj. Cariolou,  
6 znj. McKay, znj. Petrovica, znj. Healy, znj. Kolbe dhe Basile  
7 Mulera.

8 Dhe në emër të ekipit ju japim urimet më të mira për  
9 Vitin e Ri. Ju faleminderit shumë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
11 Faleminderit.

12 Z. Shala, ju lutem konfirmoni që më dëgjoni mirë?

13 I AKUZUARI:[Përmes videolidhjes] [Mikrofoni çaktivizuar]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
15 Shala, nuk ju dëgjuam. Ju lutem, thoni po ose jo nëse na  
16 dëgjoni? Thjesht për të konfirmuar që na dëgjoni. Jo, jo, nuk  
17 e dëgjojmë. Nuk e di. Askush nuk e dëgjon z. Shala.

18 Do ta verifikojmë këtë gjë, z. Shala.

19 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës  
20 këshillohen]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
22 Shala, ju lutem ndizni mikrofonin, lëshoni mikrofonin, pra,  
23 shtypeni edhe një herë butonin e mikrofonit. Sepse mund të  
24 funksionojë tani.

25 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Ju dëgjoj

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 shumë mirë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, z. Shala. Atëherë u zgjidh. Në rregull.

4 Sot do të dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit 4405, që është  
5 z. Safet Gashi. Dëshmia e tij do të jepet pa masa mbrojtëse  
6 këtu në sallë.

7 Do të zhvillojmë seanca të rregullta nga një orë e gjysëm  
8 me pushimet si zakonisht.

9 Përpara se të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit,  
10 dëshiroj që të trajtoj një çështje që ka mbetur pa zgjidhur  
11 dhe të jap dhe një udhëzim lidhur me dëshminë e dëshmitarit që  
12 do të dëgjojmë sot.

13 Sa i takon çështjes procedurale që ka mbetur pa zgjidhur,  
14 ju rikujtojmë se kemi nxjerrë një vendim mbi kërkesën urgjente  
15 të Mbrojtjes për vizitën te psikologu dhe njoftim të kërkesës  
16 për të thirrur prova që kanë lidhje me shqiptimin e dënimit me  
17 numër F750, të lëshuar më 14 dhjetor 2023, ku ZPS-ja dhe  
18 Mbrojtësi i Viktimave u udhëzuan që, nëse dëshironin, të  
19 përgjigjeshin ndaj kërkesës për të shtuar znj. Milazzo dhe  
20 aktekspertizën e saj në listën e dëshmitarëve dhe të provave  
21 dhe për të bërë të ditur nëse i kundërshtojnë kualifikimet e  
22 znj. Milazzo si eksperte apo rëndësinë e të gjithë  
23 aktekspertizës apo të një pjese të kësaj ekspertize të saj  
24 dhe, nëse po, cilat pjesë dhe këtë gjë ta bënin deri më 9  
25 janar në orën 12.00.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 Tani do ta pyes ZPS-në dhe Mbrojtësin e Viktimave nëse  
2 parashtrimet e tyre dëshirojnë t'i bëjnë gojarisht këtu në  
3 sallë apo me shkrim.

4 Z. Prokuror, ju lutem na thoni çfarë preferoni?

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Do të përgjigjemi  
6 gojarisht.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
8 rregull.

9 Z. Mbrojtësi i Viktimave, ju çfarë preferoni?

10 Z. LAWS: [Përkthim] Edhe ne do të përgjigjemi gojarisht.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
12 rregull. Do t'ia jap tani fjalën ZPS-së, më pas Mbrojtësit të  
13 Viktimave për të bërë parashtrime.

14 Z. Prokuror, keni fjalën.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ne nuk jemi kundër kërkesës së  
16 Mbrojtjes për të shtuar aktekspertizën e znj. Milazzo në  
17 listën e provave dhe nuk kundërshtojmë ekspertizën e znj.  
18 Milazzo, pra, aftësinë e saj për të bërë ekspertizën.

19 Sa i takon rëndësisë, ne si ZPS nuk e kundërshtojmë  
20 rëndësinë e aktekspertizës vetëm për qëllimet e shqiptimit të  
21 dënimit sa i takon vlerësimit të psikologes të rrethanave  
22 vetjake të z. Shala dhe rrethanave individuale. Për shembull,  
23 siç është shëndeti mendor, situata familjare, arsimimi. Këto  
24 rrethana mund të jenë pjesë e rregullës 163(1) siç ka  
25 konstatuar edhe ky Trupi Gjykues në aktgjykimin në çështjen

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 Mustafa në paragrafin 792 dhe 783 dhe 791 në aktgjykim.

2 Sigurisht, ZPS-ja do të bëjë në momentin e duhur  
3 parashtrime sa i takon peshës, nëse do të ketë, që mund t'i  
4 jepet këtij vlerësimi i cili sigurisht tani do të ishte i  
5 parakohshëm përpara se Trupi Gjykses të ketë arritur një  
6 vendimmarrje sa u takon akuzave të ngritura në aktakuzë. Ne  
7 vërejmë në lidhje me këtë, sigurisht, se disa prej observimeve  
8 të psikologes mbështeten në deklaratat të bëra jo nën betim dhe  
9 të paprovuara të z. Shala, disa prej të cilave në parashtrime  
10 se janë të pavërteta dhe bien ndesh me deklaratat që ai ka  
11 dhënë në të shkuarën. Po, sigurisht, kjo do të trajtohet në  
12 momentin e duhur dhe do të bëjmë parashtrimet tona pasi Trupi  
13 Gjykses të ketë marrë një vendim mbi këto pika.

14 Sa i takon rëndësisë, duam të bëjmë një parashtrim tjetër  
15 që ka të bëjë me një qëndrim të mbajtur nga Mbrojtja, një  
16 dispozitë ligjore më saktë mbi të cilën është mbështetur  
17 Mbrojtja në kërkesën e tyre urgjente të datës 8 dhjetor.

18 Krahas mbështetjes në rregullën 163, Mbrojtja është  
19 mbështetur dhe në nenin 141 të ligjit kosovar për ekzekutimin  
20 e dënimeve penale si një bazë tjetër shtesë. Mbrojtja nuk  
21 është mbështetur në këtë dispozitë në kërkesën e tyre për të  
22 shtuar aktekspertizën në listën e provave, por ngaqë ZPS-ja  
23 nuk ka pasur mundësi që të përgjigjet për kërkesën e parë, ne  
24 thjesht duam që të fusim në procesverbal qëndrimin tonë lidhur  
25 me këtë. Tani, neni 141 ka të bëjë edhe me një dënim

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 alternativ ndaj burgimit.

2 Tani dënimi alternativ, dhe këtë dua ta bëj shumë të  
3 qartë, nuk është një formë e mundshme e dënimit. Në rastin e  
4 Dhomave të Specializuara të Kosovës, është neni 44 i këtij  
5 ligji, e përcakton, që është vetëm dënimi me burg. Forma të  
6 tjera të dënimit, siç është, për shembull, kompensimi apo  
7 dëmshpërblimi jepet krahas burgimit.

8 Pra, duam që të jemi shumë të qartë që aktekspertiza e  
9 znj. Milazzo nuk mund të thuhet se ka rëndësi për një formë  
10 alternative të dënimit sepse në këtë dispozitë është  
11 mbështetur dhe Mbrojtja lidhur me këtë kërkesë.

12 Parashtrimi ynë i fundit ka të bëjë me kërkesën e  
13 Mbrojtjes për ta thirrur znj. Milazzo si dëshmitare.

14 Trupi Gjykses i ka urdhëruar Mbrojtjen, në paragrafin  
15 15(c) të vendimit të vetë me numër 750, që nëse dëshiron që të  
16 thërrasë znj. Milazzo për të dëshmuar krahas paraqitjes së  
17 aktekspertizës si provë materiale që të japë arsye për këtë  
18 gjë, pra, për të mbështetur kërkesën e saj.

19 Mbrojtja ka argumentuar në paragrafin 15 të kërkesës 756,  
20 vetëm se dëshmia e saj do të sqarojë disa aspekte të  
21 aktekspertizës dhe i jep mundësi Trupit Gjykses dhe palëve që  
22 të bëjnë pyetje lidhur me këto.

23 Këto parashtrime janë tepër të përgjithshme dhe nuk  
24 sqarojnë cilat aspekte të aktekspertizës duhen sqaruar dhe nuk  
25 mbështesin kështu, sipas mendimit tonë, nevojën për ta thirrur

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 atë si dëshmitare. Ata mbështeten në rregullën 141, po kjo  
2 është e gabuar sepse dëshmia e ekspertëve rregullohet nga  
3 rregulla 149. Krahas dëshmisë si ekspert, parimi i zhvillimit  
4 të procesit në formë orale në këtë rast nuk vlen, pra, në këtë  
5 aspekt. Pra, ne jemi të qëndrimit se nuk është e nevojshme që  
6 të dëgjohet kjo eksperte këtu në sallën e gjyqit.

7 Faleminderit.

8 Këto ishin parashtrimet tona.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Faleminderit.

11 Z. Mbrojtësi i Viktimave.

12 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

13 Ne patëm përparësinë që të diskutonim për këtë çështje  
14 dhe me kolegët e ZPS-së, pajtohemi me të gjitha ato që tha z.  
15 De Minicis tani dhe s'kemi asgjë tjetër për të shtuar ndaj  
16 tyre.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit.

19 Kemi vendosur në vendimin tonë që nuk do të dëgjojmë  
20 kundërpërgjigje të Mbrojtjes për këtë pikë, kështu që do të  
21 vazhdojmë tani me procesin. Ne vendimin do ta japim në  
22 momentin e duhur.

23 Ka dhe një gjë tjetër të dytë. Ka një udhëzim që dua t'ua  
24 jap palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave për dëshmitarin e  
25 sotëm, po për këtë është më mirë të kalojmë në seancë private.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1           Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

2                           [Seancë private]

3                           [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14                           [Seancë e hapur]

15           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
16 jemi tani në seancë publike.

17           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky  
18 ishte udhëzimi i Trupit Gjykues, kjo do të thotë që mund të  
19 fillojmë tani me dëshminë e Dëshmitarit 4405.

20           Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqëroheni dëshmitarin  
21 të hyjë në sallë.

22                           [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

23           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 mirëmengjesi, z. Dëshmitar.

25           DËSHMITARI: Mirëmengjes.



*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
2 se keni ardhur në Dhomat e Specializuara.

3 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta. Faleminderit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si  
5 jeni?

6 DËSHMITARI: Mirë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
8 mirë.

9 Z. Shala, e dëgjoni dëshmitarin?

10 I AKUZUARI:[Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj shumë  
11 mirë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Faleminderit.

14 Z. Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj. Për  
15 procesverbal, vërej se na është dashur që të japim  
16 fletëthirrje për të siguruar praninë tuaj këtu sallë pas  
17 refuzimit tuaj për të pasur kontakt me Mbrojtjen, pra, me  
18 Ekipin e Mbrojtjes së z. Shala.

19 Përpara se të fillojmë me pyetjet, kam disa gjera për  
20 t'jua thënë.

21 Z. Dëshmitar, ju kanë thirrur të dëshmoni përpara Dhomave  
22 të Specializuara në çështjen gjyqësore Prokurori i  
23 Specializuar kundër Pjetër Shalës për të ndihmuar Trupin  
24 Gjykes të marrë vendim. Fillimisht, do të bëni betimin  
25 solemn. Pas të cilit, do t'ju bëj pyetje Avokati i Mbrojtjes

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 së z. Pjetër Shala, përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorit të  
2 Specializuar, ata që janë të veshur me teshat me ngjyrë  
3 vjollcë, përfaqësuesit që përfaqësojnë viktimat pjesëmarrëse  
4 në këtë çështje gjyqësore, ata që janë të ulur në të majtën  
5 tuaj, më pranë jush, pastaj ne, anëtarët e Trupi Gjykues.

6 Përpara se të bëni betimin solemn dëshiroj t'ju jap disa  
7 udhëzime por edhe disa këshilla praktike sesi t'u përgjigjeni  
8 pyetjeve të cilat do t'jua bëjnë.

9 Sa u takon udhëzimeve, ju lutem dëgjojeni me kujdes  
10 secilën pyetje. Nëse nuk e kuptoni, lirisht mund të kërkonit që  
11 pyetjen t'jua përsërisin.

12 Duam që të na thoni të vërtetën dhe të na tregoni se  
13 çfarë keni parë, çfarë keni përjetuar, çfarë keni dëgjuar apo  
14 çfarë keni ndjerë ju vetë. Nëse nuk e keni parë apo nuk e keni  
15 dëgjuar ju vetë, por e keni marrë vesh në ndonjë mënyrë  
16 tjetër, na e thoni që është kështu dhe na e shpjegoni.

17 Mund të mos ju kujtohen të gjitha hollësitë e ngjarjeve,  
18 nuk ka problem për këtë. Ju lutem këtu dëshmoni vetëm për atë  
19 çfarë dini, çfarë ju kujtohet. Mos i merrni gjërat me mend,  
20 mos sajoni gjëra. Nuk ka asgjë të keqe nëse do të thoni "Nuk e  
21 di" apo "Nuk më kujtohet".

22 Ju lutem përgjigjuni pyetjeve që do t'jua bëjnë . Nëse  
23 kemi nevojë pastaj për më shumë sqarime, atëherë do t'jua  
24 kërkojmë dhe sqarimet.

25 Ju rikujtoj edhe një herë se keni të drejtën të mos

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 pranoni, pra, që të jepni dëshmi për gjërat të cilat mund t'ju  
2 fajësojnë në përputhje me rregullën 151(1) të Rregullore të  
3 Procedurës dhe Provave.

4 I kujtuat të gjitha këto?

5 DËSHMITARI: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
7 rregull.

8 Tani disa këshilla praktike për dëshminë, ju lutem mbani  
9 mend si vijon.

10 Gjithçka që themi këtu përkthehet dhe regjistrohet,  
11 prandaj është e rëndësishme që të flisni afër mikrofonit që  
12 keni përpara, të flisni qartë dhe të flisni ngadalë. Kjo u jep  
13 mundësi përkthyesve që të përkthejnë gjithçka. Kjo gjithashtu  
14 do të thotë që duhet të prisni njëherë mbasi të mbarojë pyetja  
15 pastaj të filloni të flisni. Pra, ju lutem, kur t'ua bëjnë  
16 pyetjen prisni edhe nja pesë sekonda të tjera mbasi mbaron  
17 pyetja pastaj filloni përgjigjen. Se kjo pauzë prej pesë  
18 sekondash na jep mundësi që të dëgjojmë përkthimin e asaj që  
19 po thuhet ndërkohë dhe që gjithçka të regjistrohet. Është  
20 shumë e rëndësishme të mos kemi mbivendosje me njëri-tjetrin,  
21 pra, dy folës të mos flasim mbi njëri-tjetrin.

22 Nëse unë do ta ngre dorën kështu, ju lutem mos flisni më.

23 Jua jap këtë shenjë, pra, nuk flas me gojë, në mënyrë që të  
24 mos ketë mbivendosje.

25 Ndonjëherë mund t'ju kërkojmë që të dilni nga salla nëse

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 do të jetë nevoja për të diskutuar për ndonjë çështje, për  
2 ndonjë pyetje që ju bëhet. Sepse mund të dini dhe diçka nga  
3 gjuha angleze.

4 Në fund, nëse keni nevojë për pushim, nëse ju nevojitet  
5 diçka, ju lutem mjafton të ngrini dorën dhe unë do t'ju jap  
6 fjalën.

7 A i kuptuat edhe të gjitha këto, z. Dëshmitar?

8 DËSHMITARI: Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
10 rregull. Faleminderit.

11 Z. Dëshmitar, tani do t'ju kërkoj që të bëni betimin  
12 solemn. Ju rikujtoj se përbën vepër penale në juridiksionin e  
13 Dhomave të Specializuara dhënia e dëshmisë së rrejshme. E  
14 kuptoni këtë?

15 DËSHMITARI: Po.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
17 rregull.

18 Znj. Asistente e Sallës, po ju ia dhatë tekstin  
19 dëshmitarit.

20 Ju lutem, z. Dëshmitar, lexoni deklaratën solemne.

21 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm/e ndërgjegjshme për rëndësinë  
22 e dëshmisë sime dhe përgjegjësisë time ligjore deklaroj  
23 solemnisht se do ta them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe  
24 vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë të cilën  
25 kam dijeni.

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 13

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 DËSHMITARI: SAFET GASHI

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, z. Dëshmitar.

4 Do të fillojmë tani me dëshminë tuaj me pyetjet që do  
5 t'jua bëjë Avokati i Mbrojtjes.

6 Z. Avokat, keni dy orë e gjysëm për pyetjet tuaja për  
7 këtë dëshmitar, ju lutem na informoni nëse keni ndonjë  
8 ndryshim të planifikimit tuaj.

9 Keni fjalën.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.

11 Pyetje nga z. Gilissen:

12 Z. GILISSEN: [Përkthim]

13 PY. Mirëmëngjesi, z. Dëshmitar. Siç e dini jam Avokati i  
14 Mbrojtjes së z. Shala. Jemi takuar dje disa minuta. Më quajnë  
15 Gilissen, dëshiroj që t'ju bëj disa pyetje për tema të  
16 ndryshme.

17 E para është kjo: A jeni në gjendje që të na thoni emrin  
18 dhe mbiemrin, ju lutem.

19 PË. Po. Jam Safet Gashi.

20 PY. Faleminderit shumë. A keni tani apo keni pasur ndonjë  
21 nofkë?

22 PË. Jo.

23 PY. Faleminderit. Cila është datëlindja dhe vendlindja juaj  
24 ju lutem?

25 PË. Më 22 maj 1978, Kosovë, Prizren.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Safet Gashi (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F793

Pyetje nga z. Gilissen

Faqe 14

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 PY. Faleminderit.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jemi  
3 të sigurtë? 1978. Po, faleminderit.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Për disa pyetje dëshiroj të  
5 kalojmë në seancë private, ju lutem.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
7 Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

8 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në  
9 bazë të F793

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
11 jemi tani në seancë private.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Faleminderit.

14 Z. Avokat, mund të vijoni.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë.

16 PY. Z. Dëshmitar, a keni juve ndonjë të shkuar penale, pra,  
17 historik penal?

18 PË. Jo.

19 PY. Nuk jeni dënuar asnjëherë nga ndonjë gjykatë lidhur me  
20 diçka?

21 PË. Për këtë rast e keni fjalën apo për ndonjë rast tjetër?

22 PY. Jo, jo, e kam në përgjithësi. A jeni dënuar ndonjëherë më  
23 parë?

24 PË. Po.

25 PY. Faleminderit shumë. Për çfarë ju kanë dënuar?

26 PË. Për një rast që ka pasë ndodhur [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Safet Gashi (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F793

Pyetje nga z. Gilissen

Faqe 15

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 [REDAKTUAR]

2 PY. Po. Ju kërkoj ndjesë për mikrofonin. Ishte një rast për  
3 çfarë? Çfarë vepre?

4 PË. [REDAKTUAR]

5 PY. Faleminderit shumë. Çfarë dënimi keni kryer, domethënë,  
6 sa vjet a sa muaj dhe ku e keni kryer dënimin?

7 PË. [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR].

9 PY. Faleminderit shumë.

10 Mund të rikthehemi tani në seancë publike.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë publike  
14 sërish.

15 ~~{Seancë e hapur}~~

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
17 jemi në seancë publike.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit, znj. Sekretare. Duhet të bëjmë diçka për  
20 transmetimin e z. Shala, sepse duket pa dritë, është në  
21 errësirë, do të doja ta shihja.

22 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Gjykatës  
23 këshillohen]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
25 mënyrë që t'ia shohim më mirë shprehjen e fytyrës. Megjithatë,

1 z. Avokat, ndërkohë ju mund të vazhdoni.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, vërtetë. Është në errësirë.

3 Dhe nuk është e lehtë për t'u parë.

4 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Dëshiroj tani që të flasim

5 për luftën, për periudhën para lufte. Ku keni qenë ju kur

6 shpërtheu lufta në vitin 1998?

7 PË. Në Kosovë.

8 PY. Faleminderit. Po në ç'pjesë të Kosovës?

9 PË. Në Prizren, në qytet.

10 PY. Faleminderit. A punonit ju aso kohe?

11 PË. Jo.

12 PY. Dhe në 1999 -- 1998 fillimisht, a keni qëndru në Kosovë?

13 PË. Po.

14 PY. Faleminderit. Dhe familja juaj ka qëndru në Kosovë?

15 PË. Po.

16 PY. Po kështu edhe në 1999?

17 PË. Deri në 1999 në shkurt apo në mars, nuk më kujtohet, jemi

18 dëbu nga forcat serbe për në Shqipëri.

19 PY. Po. Shkuat edhe ju me familjen në Shqipëri në atë moment?

20 PË. Jo.

21 PY. Ku ndejtët në Kosovë a diku tjetër?

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

23 ndoshta bëjmë pyetjen e hapur fillimisht, ku keni shku, ku

24 keni ndejt dhe pastaj e saktësojmë, hyjmë më në hollësi.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Në rregull.



Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 17

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 PY. Ku keni qëndru në atë kohë?

2 PË. Unë mbas nja tri dite unë jam largu pi Kosovës, mbasi  
3 kanë shku familja jeme për në Shqipëri.

4 PY. A keni shku në Shqipëri?

5 PË. Po.

6 PY. Dua të di në këtë moment, në këtë kohë a i jeni  
7 bashkëngjit UÇK-së?

8 PË. Po.

9 PY. A ju kujtohet periudha kohore ose ndoshta edhe data kur  
10 jeni kyç në UÇK?

11 PË. Nuk më kujtohet, jo.

12 PY. E pse jeni kyç në UÇK në këtë moment?

13 PË. Edhe një herë pyetjen mundësisht?

14 PY. Po, deshta me kuptu arsyen pse jeni kyç në UÇK?

15 PË. Po për të luftuar kundër forcave serbe.

16 PY. Pra, jeni kyç në vullnet të lirë, vendimi juaj i lirë?

17 PË. Po.

18 PY. A ju kujtohet çfarë moshe keni qenë kur jeni kyç në UÇK?

19 PË. Po. Mosha mund të ketë qenë 20 apo 21 vjeçar.

20 PY. Pra, keni qenë shumë i ri. Dhe deshta me dit si jeni ndih  
21 ju.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila  
23 është pyetja?

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Deshta me marrë përshtypjet e

25 dëshmitarit se mosha e tij shumë e re atëherë për me u fut në

1 ushtri.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky  
3 është përfundim në fakt.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Deshta me pa sesi e mendon, si e  
5 ka mëndu dëshmitari në atë kohë, po nuk është ndoshta shumë e  
6 rëndësishme.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
8 ta kisha riformulu, mund ta kisha parashtru pyetjen ndryshe.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim]

10 PY. A keni qenë shumë persona të kësaj moshe, të kësaj  
11 grupmoshe, domethënë, 19, 20, 21 vjeç në UÇK në atë kohë?

12 PË. Ka pasë. Ka pasë edhe të moshës edhe ma të mëdhenj.

13 PY. Ku në cilin vend jeni kyç në UÇK?

14 PË. Unë jam kyç në Kukës.

15 PY. Pra, jeni kyç në UÇK në Kukës?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe në cilin vend saktësisht në Kukës?

18 PË. Po në Kukës veç ma kanë dhënë uniformën dhe kemi shku, sa  
19 më kujtohet, në Kolsh apo në Kalimash kam pasë ndejt nja tri  
20 ditë apo katër aty.

21 PY. Pra, a ju kujtohet të keni dhënë një deklaratë disa  
22 hetuesve të ZPS-së, Zyrës së Prokurorit të Specializuar?

23 PË. Po.

24 PY. A të kujtohet shpjegimi që keni dhënë në atë moment?

25 PË. Po.

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 19

Pyetje nga z. Gilissen

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 PY. Sa i takon lidhur me vendin ku keni hy në kontakt me UÇK-  
2 në?

3 PË. Po.

4 PY. A ka nevojë që ta lexojë përgjigjen tuaj që keni dhënë  
5 atëherë për me jua fresku kujtesën?

6 PË. Po.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Me lejen e Gjykatës e kisha lexu  
8 përgjigjen e dëshmitarit që i ka dhënë hetuesve.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo  
10 që dëshirojmë të bëjmë fillimisht është që të paraqesim  
11 dokumentin në ekran, pastaj vazhdojmë si zakonisht. Pra, duhet  
12 me e dhënë referencën e dokumentit Sekretares së Gjykatës,  
13 paraqesim dokumentin dhe pastaj ia lexoni dëshmitarit dhe i  
14 bëni pyetjen që ju mendoni që duhet të bëhet.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Natyrisht. Si zakonisht.  
16 Dokumenti është 063317-TR-ET Pjesa 1 RED2. Faqe 8. Po nuk jam  
17 i sigurt për versionin në shqip. Nuk e di a e kemi versionin  
18 në shqip.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
20 qoftë se s'paraqet problem për ZPS-në dhe Mbrojtësin e  
21 Viktimave, mund të vazhdojmë edhe pa versionin në shqip. Shoh  
22 që nuk ka problem nga ana e tyre.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim]

24 PY. Faqe 8, pra, rreshti 8 deri në rreshtin 14. Fillon me një  
25 pyetje, pra, për juve, z. Dëshmitar.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Vazhdoni.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim]

4 PY. Pyetja është:

5 "A keni shku në ndonjë vend të veçantë, konkret, për me u  
6 kyç?"

7 "PË. Po, po".

8 "PY. Çfarë vendi? Ku ka qenë ky vend?"

9 "PË. Gorozhup"

10 "PY. A ka pasë bazë të UÇK-së aty a shtab? Çfarë lloji  
11 lokalesh kanë qenë aty?"

12 "PË. Ka qenë shtabi i UÇK-së".

13 Pra, z. Dëshmitar, a pajtoheni me mu që nuk është tamam-  
14 tamam e njëjta gjë? A jeni në gjendje me na e shpjegu këtë  
15 pjesë?

16 PË. Shumë në rregull je, z. Avokat. Po pyetjet kur të m'i  
17 bëni, bëmi sa herë jeni kanë në Shqipëri?

18 PY. Mund t'jua bëj pyetjen dhe pres përgjigjen --

19 PË. Po.

20 PY. -- tuaj për këtë.

21 PË. Edhe unë e dhashë --

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për

23 momentin dua që ta heqim dokumentin nga ekrani, pastaj në  
24 qoftë se keni nevojë t'i referohemi përsëri e shfaqim prapë.

25 Znj. Sekretare, hiqen dokumentin nga e ekrani ju lutem.

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 21

Pyetje nga z. Gilissen

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 Z. GILISSEN: [Përkthim]

2 PY. Pra, pyetja ime është shumë e thjeshtë. A e konfirmoni  
3 deklaratën që sapo e lexova?

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,  
5 jo, jo, nuk mund. Z. Avokat, dëgjoni.

6 Së pari, zonja punonjëse ta shoqëroni dëshmitarin jashtë  
7 sallës së gjyqit për një çast.

8 Z. Dëshmitar, do t'ju largojmë pak nga salla.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] një  
11 vërejtje nga ana ime të shkurtër, z. Avokat. Ju e pyetët  
12 dëshmitarin se ku u bashku në UÇK, ai tha në Kukës. Tani që ta  
13 pyesni tani a mund ta konfirmojë atë që ka thënë këtu në  
14 deklaratë nuk është vazhdim i logjikshëm i pyetjes, natyrshëm,  
15 i pyetjes tuaj paraprake që ishte pse tani po thotë diçka me  
16 sa duket ndryshe nga ajo që ka thënë atëherë.

17 Pra, pyetja "a mund ta konfirmoni", thjesht kjo pyetje  
18 parashtruar në këtë mënyrë, nuk mendoj që ndihmon në gjetjen e  
19 së vërtetës. Unë do ta kisha patur një qasje ndryshe nga kjo  
20 për t'u qartësuar.

21 Po ju nuk mund ta pyesni, Avokat, "a mund të konfirmoni",  
22 sepse kjo nuk ndihmon në nxjerrjen e këtij informacioni.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë po shikoja deklaratën, po i  
24 referohesha deklaratës që kishte bërë më parë, në qoftë se  
25 s'është e vërtetë, mund të rifillojmë ndryshe. Qëllimi ishte

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 22

Pyetje nga z. Gilissen

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 që të zbulojmë, të kuptojmë arsyen pse kemi këtë mospërputhje,  
2 këtë nuancë mospërputhjeje.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë  
4 e kuptoj, por s'ka nevojë të përsërisë atë që thashë, besoj që  
5 e bëra të qartë atë që kisha për të thënë.

6 Znj. Sekretare, na sillni dëshmitarin në sallë përsëri.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
9 se erdhët.

10 DËSHMITARI: Faleminderit.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund të vazhdoj?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
13 të vazhdoni.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim]

15 PY. Z. Dëshmitar, keni një dallim mes deklaratës që i keni  
16 dhënë hetuesve --

17 PË. Po.

18 PY. -- dhe ajo që u tha në këtë sallë gjyqi. Pra, në qoftë se  
19 ju mendoni që ka një dallim, a mund ta shpjegoni këtë dallim  
20 dhe pastaj të na thoni pse janë dy deklaratatë të ndryshme, pra,  
21 pse ky informacion është ndryshe?

22 PË. Nuk janë dy deklaratatë të ndryshme, z. Avokat.

23 PY. A mendoni që është e njëjta apo ka ndonjë ndryshim të  
24 vogël?

25 PË. E njëjta deklaratë është.

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 23

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 PY. Atëhere, Gorozhupi është afër, shumë afër Kukësit?

2 PË. Jo. Gorozhupi është brenda në Kosovë.

3 PY. Në rregull. Kur jeni kyç në UÇK, a e keni bërë këtë, a ka  
4 ndodhë kjo në Gorozhup a në Kukës?

5 PË. Në Gorozhup.

6 PY. Në Gorozhup, pra. Faleminderit. A ka pasë shtab të UÇK-së  
7 në Gorozhup?

8 PË. Po.

9 PY. Sipas mendimit tuaj, a ka qenë i vetmi shtab i UÇK-së?

10 PË. Sa muj me ditë unë, po, shtabi ynë a kanë veç.

11 PY. Faleminderit. Z. Dëshmitar, na tregoni pak momentin kur  
12 keni mbërri, jeni regjistru në UÇK e këto.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

14 Avokat, duket të përcaktoni periudhën kohore për të cilën po  
15 flasim, për afërsisht të paktën. Mund ta bëj vetë këtë pyetje,  
16 preferoj t'jua lë juve. Ju keni radhën e pyetjeve.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim]

18 PY. Pyetja është kur jeni kyç në UÇK. Ju thatë që kjo ka  
19 ndodhë në Gorozhup --

20 PË. Po.

21 PY. -- vendi. Tani koha kur ka ndodhur?

22 PË. Mars, sa më kujtohet, viti 1999.

23 PY. Faleminderit. Pra, me sa kuptoj unë keni shku prej Kosove  
24 në Gorozhup apo keni shku keni udhëtu diku tjetër?

25 PË. Në Gorozhup.

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 24

Pyetje nga z. Gilissen

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 PY. Domethënë, nga Prizreni drejt e në Gorozhup.

2 PË. Po.

3 PY. Faleminderit. Kur keni mbërri në Goruzup, çfarë ka ndodhë  
4 në atë moment?

5 PË. Asgjë. Ka pasë luftime, kësisoj.

6 PY. Dhe ju jeni kyç në UÇK. A jeni në gjendje me e spjegu  
7 procesin gjysh hyhej në UÇK?

8 PË. Po. Të japësh betimin, sikurse këtu. Të stërvitesh, pak a  
9 shumë, nja dhjetë ditë, të marrësh uniformën. Edhe këto janë.

10 PY. A keni nënshkru ndonjë dokument? A jeni taku me ndonjë  
11 epror, ndonjë oficer? A keni diçka më shumë lidhur me këtë?

12 PË. Po. Kam nënshkrimin emnin, mbiemnin, emnin e babës, viti  
13 i datëlindjes.

14 PY. A të kujtohet cila brigadë a njësi e UÇK-së të cilës i je  
15 bashku në atë moment?

16 PË. Po. Brigada 128, komandant i Shtabit të Përgjithshëm  
17 është Ruzhdi Saramati.

18 PY. Faleminderit. A je taku me ta?

19 PË. Po.

20 PY. Sa herë je taku me ta?

21 PË. Po ka pasë -- kur ka pasë naj me na dhënë ndonjë  
22 deklaratë, naj i sen e kam pa për afërsisht nja dy-tri herë.

23 PY. Faleminderit. Ne dëshirojmë me kuptu kur jeni taku me ta  
24 në Gorozhup, kur e ke taku?

25 PË. Në 1999, në luftë.



1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Avokat, ju ia dhatë përgjigjen se ku e kishte taku, të vendit.

3 Se dëgjova nja katër-pesë pyetje të mbyllura dhe tani ju

4 përsëri ju po jepni atij informacion që është tepër i

5 kufizuar. Pra, përpiquni që t'i nxirrni informacionet nga

6 dëshmitari, jo informacione që ju ia jepni të gatshme.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim]

8 PY. Pyetja e radhës ishte ku është bë kjo stërvitje në

9 Gorozhup dhe a e keni pa shefin e shtabit vetë në Gorozhup?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do

11 t'jua jap fjalën, znj. Prokurore.

12 Pyetja ime ishte kur është taku me z. Saramati, kur ka

13 marrë udhëzime nga z. Saramati, ndërsa ju e kufizuat pyetjen

14 me Gorozhup, vendin, nuk ishte kjo pyetja.

15 Znj. Prokurore, keni fjalën ju.

16 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Duam që të shënohet në

17 procesverbal se Mbrojtësi vazhdon t'i bëjë pyetje sugjestive

18 dëshmitarit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

20 na ndihmon që të marrim dëshminë e dëshmitarin siç duhet duke

21 bërë pyetje sugjestive të kësaj natyre. Dhe kur e pyetët ju: A

22 jeni kyç në UÇK? Mund ta kishit pyetur edhe ça keni bë në

23 Shqipëri?

24 Pra, ju lutem keni parasysh të bëni pyetje sa më të

25 hapura.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 26

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] E kuptoj.

2 PY. Trajnimin, stërvitjen që keni bërë, a e keni bërë vetëm në  
3 Gorozhup a dhe diku tjetër?

4 PË. Vetëm në Gorozhup.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

6 Avokat, një çast ju lutem.

7 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, por dëshmitari më  
8 parë tha që trajtimi, stërvitja është bërë Kolsh apo në Kalimash  
9 dhe jo në Gorozhup. Tani edhe në këtë rast Mbrojtja po e  
10 udhëzon dëshmitarin në përgjigjet e tij.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit, znj. Prokurore.

13 Po. Do t'ju jepet fjala tani, z. Dëshmitar.

14 Z. Avokat, keni parasysh edhe këtë pikë -- qëndrim të  
15 Prokurorisë. Në qoftë se ju citoni diçka që ka thënë  
16 dëshmitari më parë, ju lutem jepni referencën. Dhe në qoftë se  
17 kundërshtoni atë që tha znj. Prokurore, duhet të na tregoni ku  
18 tha dëshmitari që kishte bërë trajnim, stërvitje në Gorozhup.

19 Z. Dëshmitar, çka patët për të thënë?

20 DËSHMITARI: Nuk thashë unë, znj. Prokurore, se kam kry  
21 stërvitje as në Kukës, as në Kolsh. Po kam shku në Kolsh tri-  
22 katër ditë është fjala.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

24 Avokat, vazhdoni.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim]

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 27

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 PY. Z. Dëshmitar, ku jeni stërvit që të shmangim çdo lloj  
2 problemi, ku keni bë stërvitjen?

3 PË. Stërvitjet i kam kry në Gorozhup.

4 PY. Faleminderit shumë. Dhe a të kujtohet ku ka qëndru kjo  
5 Brigada 128? A ka qëndru vetëm në Gorozhup apo në ndonjë vend  
6 tjetër apo? Ma sqaro?

7 PË. Unë jam tu fol për brigadë teme. Brigada është 128. Unë  
8 për vete jam kanë, kam kry ushtrimet në Gorozhup.

9 PY. Pra, mund të themi që Brigada 128 ka qëndru vetëm në  
10 Gorozhup apo edhe në vende të tjera?

11 PË. Ka pasë edhe vende të tjera, po nuk jam në dijeni ku kanë  
12 ndejt.

13 PY. Në rregull. Shumë e qartë. Faleminderit. Gjatë kësaj  
14 periudhe kohore kjo brigada a ka lëvizë ndonjëherë?

15 PË. Për brigadë teme nuk them se po.

16 PY. A jeni në gjendje me na sqaru pak më tej, me na dhënë pak  
17 më shumë informata, hollësi kur thoni këtë?

18 PË. Po. unë për vete nuk kam lujt kërkah. Aty kam nejt se ka  
19 pasë luftime.

20 PY. Z. Dëshmitar, a jeni në gjendje me na sqaru si ka qenë e  
21 organizume kjo brigadë? Cilat njësi i ka pasë mbreda kështu?

22 PË. Po ka pasë njësi speciale, njësi të njësitit të minave  
23 për çmontimin e minave edhe ka pasë ushtarë normal.

24 PY. Në cilën prej këtyre njësive ke qenë ti?

25 PË. Njësi speciale kam qenë.

1 PY. Njësi speciale. Në rregull. Cilat kanë qenë punët apo  
2 detyrat e kësaj njësie speciale?

3 PË. Detyrat e kësajna, jemi kanë në vijë të parë të frontit.  
4 Domethënë, ky tog merr pi 11 deri në 15 ushtarë.

5 PY. E në vijën e frontit, cila ka qenë detyra jote në vijën e  
6 frontit? A e ke qenë luftëtar a ke pasë detyra të tjera apo  
7 cilat?

8 PË. Jo, luftëtar kam qenë.

9 PY. Shumë e qartë. Në rregull. Faleminderit. Pra, gjatë kësaj  
10 periudhe që ke qenë UÇK, a ke njof një person me emrin Pjetër  
11 Shala?

12 PË. Kurrë në jetë s'e kam njoft atë njeri. As që e kam pa  
13 ndonjëherë.

14 PY. Gjatë luftës apo në përgjithësi --

15 PË. Në përgjithësi.

16 PY. -- dhe në periudha të tjera kurrë s'e ke taku?

17 PË. Në përgjithësi kurrë në jetë teme pa atë njeri s'e kam.

18 PY. A ke ndëgjju ndonjëherë ndonjë gjë për këtë person gjatë  
19 periudhës së luftës?

20 PË. Kurrë në jetë. Ju betohem.

21 PY. Në rregull. Faleminderit. A ke qenë ndonjëherë në Kukës,  
22 në Shqipëri gjatë luftës?

23 PË. Këtu deshta me dalë, z. Avokat. Po.

24 PY. A je në gjendje me na sqaru se kur?

25 PË. Dita s'më kujtohet, po mars u kanë. 1999 viti kam shku me

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 29

Pyetje nga z. Gilissen

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 katër-pesë shokë për me marrë armatim. Kjo dhe pyetje ma herët  
2 që thashë që jam kanë në Shqipëri.

3 PY. E ku në cilin vend në qytetin e Kukësit keni shku? Ku  
4 saktësisht

5 PY. Jo, në Kukës veç jemi ndalë pak, kemi pushu. Nuk thashë  
6 se kemi nejt në Kukës, po në Kolsh. Në Kolsh apo në Kalimash  
7 nuk më kujtohen këto dy katunde.

8 PY. Nuk të kujtohet në cilin vend në Kukës ke qenë?

9 PË. Jo.

10 PY. Në Kukës a ke pa një ish-uzinë, fabrikë?

11 PË. Jo.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Znj. Gjykatëse, me lejen tuaj, do  
13 doja të citoj një pjesë të deklaratës që dëshmitari i ka dhënë  
14 hetuesve.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cili  
16 është qëllimi?

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Lidhur, ka të bëjë me praninë e  
18 tij në Kukës dhe fakti që ka qenë apo s'ka qenë në Kukës.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
20 rregull.

21 Znj. Sekretare, shfaqni në ekran dokumentin e referuar,  
22 ju lutem.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dokumenti në fjalë është 063317-  
24 TR-ET Pjesa 2 RED2, faqja 13, rreshti 3 deri në rreshtin 9.  
25 Faleminderit shumë.

1 PY. Z. Dëshmitar, do të lexoj një pjesë të deklaratës që i  
2 keni dhënë hetuesve në shtator 2019. Në këtë pjesë ju ishit,  
3 keni fol për familjen dhe keni thënë:

4 "Po, kanë jetu në Kukës".

5 PË. Po.

6 PY. "A kanë qëndru ata aty gjatë gjithë kohës?"

7 "PË. Mendoj që njëni prej vëllezërve të mi ka shku në  
8 një vend. Tjerët kanë nejt në Kukës".

9 "PY. A ke shku ti i ke pa ata në Kukës një herë?"

10 "PË. Jo, s'kam mujt me hy atje".

11 Dhe desha që të përqendrohemi tani te një pjesë tjetër e  
12 deklaratës.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] I njëjti dokument, faqja 14,  
14 rreshti 6 deri në 13.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Vazhdoni.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim]

18 PY. "A e dini nëse janë mbajtur të ndaluar civilë në shtabin  
19 e Brigadës 128 në Kukës?"

20 "PË. Nuk e di. Ju thashë më herët -- ju thashë më herët  
21 që unë s'kam qenë kurrë në Kukës. Mu më kanë dhënë armët.  
22 Armët m'i kanë sjellë, m'i kanë pru mu dhe distanca ka mujt me  
23 qenë diçka si mes këtujit dhe hotelit ku jam tuj nejt tash.  
24 Pra, kam shku i kam marrë armët diku këtu dhe mandej jam kthy  
25 aty ku kanë qenë shokët e mi".

1 Kjo ka qenë deklarata juaj. Dhe desha që të sigurohem që  
2 s'kam bë ndonjë gabim dhe të kuptoj që s'kam bë gabim kur i  
3 lexoj këto deklaratat tuaj. A mundeni, a jeni në gjendje me na  
4 sqaru situatën saktësisht si ka qenë?

5 PË. E saktë është kjo që e kam dhënë në këtë deklaratë.

6 PY. Po lexoj në pasazhin e fundit, po citoj:

7 "...nuk kam qenë kurrë në Kukës".

8 Dhe pak më parë pata ndjesinë se ju u përgjigjët se ishit  
9 në Kukës.

10 PË. Po.

11 PY. A mund të na e shpjegoni pak këtë gjë?

12 PË. Po jo në shtab. Unë jam kanë në Kukës, po jo në shtab. As  
13 nuk e di ku është ai shtab në Kukës.

14 PY. Keni ndjesinë se kishte një shtab në Kukës UÇK-ja?

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë  
16 s'e kuptoj pyetjen, z. Avokat.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mendoj se dëshmitari na shpjegoi  
18 se nuk ka qenë në shtabin e UÇK-së në Kukës, kështu që unë dua  
19 që të sigurohem se e kam kuptuar siç duhet, për të mos mbajtur  
20 procesverbal diçka që ai nuk e ka thënë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
22 përgjithësi nuk e kuptoj pyetjen tuaj lidhur me shtabin. Mund  
23 ta riformuloni, ju lutem.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, në rregull.

25 PY. Pak më parë na thatë se kishte një shtab të UÇK-së në

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 32

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 Gorozhup dhe sipas jush --

2 PË. Po.

3 PY. Tani kam një pyetje. Sipas jush, a kishte në Kukës një  
4 shtab tjetër të UÇK-së?

5 PË. Nuk e di. Nuk jam i informum.

6 PY. Faleminderit shumë. Shumë e qartë. Tani një pyetje për  
7 distancën, për largësinë. Pakëz më parë ju folët për largësinë  
8 midis vendit ku ndodheshit ju dhe hotelit. Sipas jush,  
9 ç'largësi kishte kjo?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
11 lutem, përcaktoheni pak më mirë se ku ndodhej ose të paktën na  
12 jepni referencën për procesverbalin, sepse kështu pyetja  
13 mbetet në ajër.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Është një interpretim që unë sapo  
15 bëra pak më përpara, një pyetje, pra, që bëra pak më përpara.  
16 Nuk e di me saktësi se ku ishte.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
18 ajo është në ekran.

19 "Armët na i sollën, na i sillnin dhe distanca, largësia,  
20 pra, duhet të ishte diçka si midis këtu dhe hotelit ku jam  
21 tani". Dhe pyetja jua j është: Sa ishte kjo largësi?

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, absolutisht.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
24 Dëshmitar.

25 DËSHMITARI: Largësia është, këtë deshta me cekë, është



Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 33

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 kufiri mes Kosovës dhe Shqipërisë. Fshati ma i afërt për  
2 Shqipëri është Gorozhupi. Këtë deshta me cekë unë edhe më  
3 herët.

4 Distanca mundet me kanë sa këtu te hoteli. Aq ka.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim]

6 PY. Dhe sipas jush, sa kilometra, sa metra midis këtyre dy  
7 vendeve?

8 PË. Po ky fshat për kën kam fjalën unë, Gorozhup, e ka  
9 kufinin e Shqipërisë 3 deri në 5 kilometra më tepër hiç.

10 PY. Faleminderit shumë. Dhe mes Gorozhupit dhe Kukësit sa  
11 kilometër janë, sipas jush?

12 PË. Për nder këtë nuk e di. Po janë dikun përafërsisht 35, 36  
13 kilometra, përafërsisht.

14 PY. Mirë. Faleminderit shumë. Dokumentin mund ta lëmë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
16 Sekretare, mund ta hiqni dokumentin.

17 Dhe për procesverbalin, dëshiroj që të vërej se e kam  
18 parë dëshminë e dëshmitarit sot sa i takon stërvitjes dhe  
19 është e saktë, z. Avokat, se dëshmitari - dhe e kam fjalën për  
20 faqen 17, rreshti 5 a 4 - që ai flet për "Kolshin ose  
21 Kalimashin ku ka kena nejt tre a katër ditë", "ku kanë marrë  
22 uniformën" po nuk thotë asgjë për stërvitje.

23 Pra kur jua bëra këtë pyetje, ju kishit të saktë që nuk  
24 janë përmendur këto dy vende.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, po, është e sigurt. Është e

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 34

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 sigurt. Prandaj dhe pata problem përgjigjen sepse kjo çështja  
2 e stërvitjes është një gjë e veçantë. Faleminderit shumë.

3 PY. Z. Dëshmitar, në këtë moment të luftës në vitin 1999, a  
4 ishit ju në dijeni për pretendimet se UÇK-ja arrestonte dhe  
5 mbante të ndaluar civilë, njerëz civilë në disa qendra të  
6 ndryshme në Kosovë apo në Shqipëri?

7 PË. Sa më kujtohet mu, kurrë s'kem pat të bëjmë me civilë  
8 Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

9 PY. Pra, e keni fjalën që me aq sa keni pa, aq sa keni pa ju  
10 vetë apo me aq sa dini ju?

11 PË. Aq sa kam pa, aq sa di, kurrë me civilë nuk janë marrë  
12 UÇK-ja.

13 PY. Faleminderit shumë. A keni marrë urdhra apo stërvitje, a  
14 ju kanë stërvit për mundësinë për të kontrollu apo arrestu  
15 civilë?

16 PË. Nuk është e vërtetë kjo.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

18 Dëshmitar, sa për ta kuptuar, kur thoni, çfarë doni të thoni  
19 kur keni thënë "Nuk kena pasë me bë asnjëherë me civilë, nuk  
20 kena pasë me bë"?

21 DËSHMITARI: Nuk kemi pasë të bëjmë me civilë kurrëgjë,  
22 përpos me ushtarët serbë në uniformë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
24 s'e kemi fjalën këtu për lidhje apo "për kena pasë me bë", po  
25 flasim për pretendimet që UÇK-ja arrestonte dhe burgoste

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 35

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 civilë. Nuk është, pra, pyetja është a keni dijani --

2 DËSHMITARI: Jo. Kam --

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] -- që  
4 UÇK-ja bënte diçka të tillë?

5 DËSHMITARI: -- dijani dhe nuk është kjo e vërtetë, që kem  
6 arrestu civilë. Civilë as serbë nuk kemi arrestu se lë mo  
7 shqiptarë apo diçka tjetër.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ishte  
9 paksa kriptike, pra, e padeshifrueshme përgjigja fillimisht,  
10 pra, "kurrë s'kena pasë me bë" po tashti është e qartë për  
11 çfarë flasim.

12 Keni fjalën, z. Avokat.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë.

14 PY. Ajo që sapo thatë sa për tani është, pra, këtë që e thatë  
15 mbështetet në faktin që ju keni qenë në front apo se nuk keni  
16 dëgjua asnjëherë, s'keni marrë vesh që të jenë arrestuar  
17 civilë, pra, as pas lufte nuk keni dëgjuar përgjithësisht që  
18 ka pasë të arrestum civilë?

19 PË. Jo, këtë s'e kam dëgju kurrë unë.

20 PY. Faleminderit shumë, z. Dëshmitar. Çfarë bëtë pastaj mbasi  
21 përfundoi lufta?

22 PË. Mbasi përfundoi lufta, kam nejt në një kamp afër  
23 periferisë së Prizrenit, në Nashec, nja pesë-gjashtë ditë.  
24 Edhe aty e kam lënë, domethënë, Nashecin, kam shku në shtëpi  
25 teme, e kam hek uniformën edhe më kund s'kam shku.

2 Në fakt, në atë intervistë, ju është bërë pyetja nëse ka  
3 pasur ndonjë vend ku flinin natën ushtarët. Kësaj pyetjeje ju  
4 i jeni përgjigjur, se "nuk kishte shtëpi ku mund të qëndronim  
5 se NATO-ja bombardonte vendin po kështu edhe serbët  
6 sulmojshin".

7 Dhe kjo është në pjesën e parë të deklaratës së  
8 Dëshmitarit me numër 063317, faqe 14, rreshtat 2 [Sipas  
9 përkthimit] deri në 7.

10 Ju kujtohet që keni thënë kështu?

11 PË. Po, është e vërtetë. Po krejt shtëpiat nuk janë kanë të  
12 shkatërrume, znj. Prokurore. Ka pasë ndonjë shtëpi që s'është  
13 kanë e shkatërrume. Kemi mujtë me flejtë aty. Se çdo shtëpi  
14 nuk është kanë e bombardume.

15 PY. Se në atë deklaratë ju keni thënë diçka më konkrete, keni  
16 thënë se nuk kishte asnjë vend ku me ndejtë për shkak të  
17 granatimit. Por sot po thoni që kishte disa shtëpi ku ju mund  
18 të flejshin natën. A mund të na ndihmoni që ta kuptojmë se  
19 çfarë keni dashtë me thanë përpara se duket se ka një farë  
20 mospërputhje midis asaj që keni thënë përpara në intervistë  
21 edhe asaj që po thoni sot.

22 PË. Ka pasë shtëpija, ama janë kanë njëkatëshe, dykatëshe,  
23 asgjë s'ka ndodhë, po janë kanë pak. Në krejt në atë fshat në  
24 qofshin kanë dy-tri shtëpi. Edhe ata kur kemi flejtë kemi  
25 flejtë me tutë. Mos po granatohet ajo shtëpi. Se të tjerat

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 91

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 janë kanë krejt të shkatërrume.

2 PY. Z. Dëshmitar, po përpiqem të kuptoj diçka më mirë në  
3 dëshminë tuaj. Thatë se në Gorozhup kishte luftime, granatime,  
4 gjatë kohës që ju ishit aty. Pra, nga ajo që po thoni ju,  
5 është që nuk ishte dhe vende të përshtatshme për me ndejtë,  
6 sepse shtëpitë ishin të dëmtuara rëndë. Kuzhinë nuk kishte,  
7 ushqimin jua sillnin këta personat e logjistikës. Pra,  
8 infermieri kishte, por rastet më të rënda dërgoheshin diku  
9 tjetër.

10 Pra, ishte një vend i rrezikshëm të themi, ishte fronti.

11 PË. Saktë.

12 PY. Nuk duket si ndonjë vend ku UÇK-ja mund të kishte një  
13 bazë apo një qendër rekrutimi. Mua më shumë më duket si një  
14 vend, një pararojë ushtarake, pra një front ushtarak. A nuk do  
15 të ishte kjo mënyra më e mirë për ta përshtatur këtë --

16 PË. Ashtu.

17 PY. -- vendin ku ju kishit, ku ndodheshit në Gorozhup? Do të  
18 doja tani t'i kthehem asaj që për të cilën ju folët pra për  
19 luftimet dhe për granatimin e rëndë. Ju kujtohet ndonjë rast  
20 konkret i një granatimi sidomos të rëndë prej të cilit UÇK-ja  
21 pati dhe humbje në njerëz? Siç thatë ju më përpara, sigurisht,  
22 por a ju kujtohet ndonjë rast konkret?

23 PË. Po, po, më kujtohet. Tregova dhe pak ma herët. Më  
24 kujtohet shumë mirë se kemi pasë edhe ne të plagosun, edhe të  
25 vramë, por kanë pasë edhe prej forcave serbe se kanë pasë të

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 92

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 vramë e të plagosur ata njëjtë.

2 PY. Ju kujtohet sa vdekje, pra sa të vdekur patët ju në atë  
3 rast?

4 PË. Po, prej fillimit të luftës deri në mbarim të luftës,  
5 domethënë, në brigadën time janë të vrarë, ushtarë e kam  
6 fjalën, prej forcave serbe dikund 27 apo 28 dëshmorë janë.  
7 Përafërsisht.

8 PY. Z. Dëshmitar, keni dëgjuar ndonjëherë për një incident  
9 apo për një luftim të veçantë që quhet beteja e Gorozhupit?

10 PË. Jo.

11 PY. Keni dëgjuar ndonjëherë për, apo keni pasur ndonjëherë  
12 dijeni, a keni njohur ndonjëherë një person të quajtur Sali  
13 Saramati?

14 PË. Po.

15 PY. Kush është ai?

16 PË. Kushëri i komandantit tim është, Sali Saramati. Kurse  
17 komandanti im është Ruzhdi Saramati. Po, është i vramë nga  
18 forcat serbe në Gorozhup.

19 PY. Ju kujtohet se kur ka vdekur?

20 PË. Nuk më kujtohet për nder kjo.

21 PY. Po përgjithësisht të themi ishte nga fillimi i qëndrimit  
22 tuaj aty, nga fundi i qëndrimit tuaj aty, nga mesi i qëndrimit  
23 tuaj aty?

24 PË. Përafërsisht nuk më kujtohet aq mirë, por mundet me kanë  
25 edhe mesi. Përafërsisht po them, mesi i ditëve të mia.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 93

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund ta  
2 ndihmoj dëshmitarin me sa i takon kohës duke përdorur një  
3 dokument i cili flet për këtë ngjarje?

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
5 mundet.

6 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Kërkoj materialin 4 të listës së  
7 ZPS-së, me numër ERN 108011 deri në 108040 në shqip. Ndërsa në  
8 anglisht është i njëjti numër prove, por që mbaron me  
9 shkronjat ET.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
11 Sekretare, mund të veproni.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në faqen 9  
13 të dokumentit.

14 PY. Z. Dëshmitar, ky dokument, është, më duket se është  
15 rreshti i dytë nga sipër si në shqip dhe në anglisht. Flet për  
16 betejën në Pashtrik, pikërisht në Gorozhup.

17 PË. Ashtu është.

18 PY. Dhe thotë se:

19 "Data 31 maj 1999 është një datë e veçantë. Kjo ditë na  
20 kujton betejën më të vështirë dhe më të lavdishme, Dita D. Në  
21 këtë ditë sulmojnë forcat armike të Brigadës së Jugut, që e  
22 quanin armiqtë."

23 A ju kujton kjo tani se kur ka ndodhur beteja e  
24 Gorozhupit? Mbase jua rifreskon kujtesën kjo gjë.

25 PË. Shumë mirë po më kujtohet edhe kjo, por nuk është veç një

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 94

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 ditë që kemi pasë, sikur thashë edhe ma herët, beteja. Beteja  
2 në luftë ka pasë çdo ditë aty, por kjo në fakt është një që  
3 nuk harrohet kurrë se ka pasë atë ditë shumë tepër granatime  
4 nga forcat serbe.

5 PY. Z. Gashi, na thatë lidhur me këtë se Sali Saramati vdiq  
6 në betejë, është e saktë kjo?

7 PË. Ashtu.

8 PY. Ju kujtohet nëse ky është një prej atyre që ka vdekur  
9 pikërisht në këtë rast pra më datë 31 maj?

10 PË. Këtë nuk muj me siguri kurrëgjë me çfarë date, apo me sa  
11 ka vdekë ai person.

12 PY. Ju kujtohet se çfarë i ka ndodhur trupit të Sali  
13 Saramatit pasi vdiq në Gorozhup?

14 PË. Jo, se i kanë transferu sikur, tash, sikur kufomat sikur  
15 të lëndumit i kanë transferu në të tjera qytete apo të tjera  
16 diçka, ashtu, fshatra. I kanë largu, domethënë, prej vijës së  
17 frontit, i kanë largue. Nuk e di çka ka ndodhë.

18 PY. Ju, a e dini se ku i kanë transportu, ku i kanë çuar? Se  
19 thatë në zona të tjera në fshatra të tjerë, por ku, a e dini  
20 se ku?

21 PË. Nuk e di, këtë nuk e di. Jo, s'kam informacion.

22 PY. A dini gjë është organizu një ceremoni funerali, varrimi,  
23 për Sali Saramatin?

24 PË. Po gjatë luftës nuk kanë mujtë me ndodhë, domethënë,  
25 ceremoni se është kanë luftë, por mbas lufte mes rivarrosjeve

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 95

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 të ushtarëve të UÇK-së shumë ka pasë ceremoni, po.

2 PY. Z. Gashi, keni dëgju ndonjëherë për një person të quajtur  
3 Mark Shalaj?

4 PË. Kurrë në jetë.

5 PY. Mark Shalaj ishte anëtar i UÇK-së, merrej me logjistikë  
6 në Shqipëri gjatë lufte, dhe këtu në këtë gjykim ka dëshmuar  
7 si, në tetor, si dëshmitar i Mbrojtjes. Ai ka deklaruar se Sali  
8 Saramati ishte vërtet një kushëri i Ruzhdi Saramatit siç e  
9 thatë dhe ju, pra, komandanti i Brigadës 128 dhe është vrarë  
10 gjatë luftimeve të betejës së Gorozhupit.

11 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Dhe faktikisht për referencë për  
12 Trupin Gjykues dhe për të gjithë është transkripti i datës 23  
13 tetor 2023, faqen përkatëse.

14 PY. Mark Shalaj gjithashtu ka dëshmuar se pas vdekjes Sali  
15 Saramatin, kufomën e tij, të Sali Saramatit e çuan në Kukës,  
16 dhe u zhvillua një ceremoni mortore aty për atë, si edhe për  
17 ushtarët e tjerë të vrarë në varrezat e Kukësit.

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Dhe kjo gjendet në të njëjtën  
19 faqe transkripti, pra nga faqja 3001 deri në faqen 3004.

20 PY. Mark Shalaj konfirmoi se ishte një ngjarje e madhe,  
21 faktikisht, pra ju po thoni që s'keni dëgjuar kurrë për këtë  
22 funeral të këtij ushtari, pra të Sali Saramatit?

23 PË. Tregova, thashë që me u vra, u vra. Datën e saktë nuk e  
24 mbaj mend, edhe tregova shumë mirë se i kanë transferu diku.  
25 Më duket e thashë, këtë përgjigje ta dhashë. Ama se ku i kanë

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 96

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 çu, vendndodhjen nuk e di.

2 Edhe na, domethënë, në qoftë se u vra një ushtar apo një  
3 komandant, nuk kemi mujt me lanë krejt ushtria luftën e me  
4 shku me bo një nderim të një ushtari, po e zëmë. Dikush ka  
5 pasë me ndejtë në luftime. Unë për vete nuk kam shku. Kam  
6 qëndru në vijë të frontit.

7 PY. Z. Gashi, nëse ju kuptoj qartë atëherë ju e dinit, kishit  
8 dijeni që u zhvillua ky funeral në Kukës, kështu, është e  
9 saktë kjo?

10 PË. Jo, jo. Nuk thashë ashtu, nuk thashë.

11 Z. AOUINI: [Përkthim] Më falni, e nderuar Gjykatëse. Ai  
12 nuk tha kështu. Ai thjesht përmendi rivarrimin, pra, pas  
13 lufte, por ai tha se nuk ishte në dijeni që të ishte zhvilluar  
14 diçka e tillë gjatë kohës që ai ishte në front.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
16 besoj se dëshmitari pikërisht para se të flisnit ju e tha dhe  
17 këtë që, e tha pra që nuk kishte dijeni.

18 Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

19 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Mbase  
20 edhe unë po nxitoja pak, por dëshmitari tha në faqen 92,  
21 rreshtat 15 deri në 19, tha:

22 "...do të kishte qenë e pamundur për të gjithë ne që të  
23 braktisnim frontin dhe të shkonim të merrnim pjesë në një  
24 ceremoni varrimi. Duhej që dikush të qëndronte mbrapa, unë  
25 isha prej atyre që nuk shkuan, qëndrova në front."



Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 97

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 Dhe mbase unë nga kjo kuptova që dëshmitari e dinte që u  
2 zhvillua kjo ceremoni varrimi, por mbase e keqkuptova unë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
4 mund ta pyesim dëshmitarin. Do t'jua japim fjalën edhe juve z.  
5 Dëshmitar.

6 Edhe Avokatit të Mbrojtjes, por edhe unë kështu e  
7 kuptova. Por e dëgjuam dëshmitarin që mbase ka dashur të thotë  
8 diçka tjetër. Kështu që do t'ia jap fjalën Prokurores që ta  
9 eksplorojë më tej këtë gjë.

10 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

11 PY. Z. Dëshmitar, ju vetëm na e sqaroni. Po i kthehemi dhe  
12 një herë asaj që na thatë pak më përpara. Thatë që se ai ra në  
13 luftime, se ai vdiq, pra këtë e dinit që ai vdiq?

14 PË. Po.

15 PY. Në rregull. Dhe folët edhe për një ceremoni varrimi.

16 PË. Nuk fola unë, ti fole. The se u mbajt një ceremoni  
17 varrimi. Unë thashë nuk e di. Tregova dhe ma herët, thashë i  
18 kanë transportu, por ku, nuk di. E rivarrim unë nëse e kujtova  
19 thashë mbas lufte, janë rivarrosur, janë varrosur në  
20 Landovicë, dëshmorët. Këtë po.

21 PY. Faleminderit për sqarimin. Pra, nuk dëgjuat, nuk keni  
22 dëgjuar kurrë që u zhvillua kjo ceremoni mortore për Sali  
23 Saramatin gjatë luftës? Pra një ceremoni për ta varrosur atë  
24 gjatë luftës, e kam fjalën?

25 PË. Unë s'kam dëgju.

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 98

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 PY. Po ju pyes, z. Dëshmitar, sepse ne dimë nga një dëshmitar  
2 tjetër i Mbrojtjes që ka ardhë dhe ka dhënë dëshmi në këtë  
3 gjykim, Zijadin Hoxha se shumë ushtarë nga brigada e Ruzhdi  
4 Saramatit kanë marrë pjesë në këtë varrim në varrezat e  
5 Kukësit. Ai ka thënë se janë largu ata, pra, ushtarët nga vija  
6 e frontit për, edhe kanë marrë pjesë në varrim dhe mandej janë  
7 kthyer prapë në vijën e frontit.

8 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Kjo, transkripti i datës 20  
9 nëntor 2023, faqet 2073 [Sipas përkthimit] deri në 2047 [Sipas  
10 përkthimit].

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
12 ta hiqni dokumentin nga ekrani?

13 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po.

14 PY. Pra, dhe një herë, z. Dëshmitar, a është dëshmia juaj sot  
15 që ju vetë nuk keni dëgju dhe as ma pak marrë pjesë, në këtë  
16 varrim që është bë për një shok të Brigadës 128, ushtar, që  
17 sikur ju edhe ai ka luftu në Gorozhup gjatë luftës? A është  
18 kjo dëshmia juaj sot?

19 PË. Kjo është dëshmia jeme, edhe që e thashë edhe ma herët,  
20 me të dëgjume as që kam dëgju, as kurrgjë. As nuk jam kanë,  
21 por jam ndejtë në vijë të frontit thashë. Nuk e di.

22 Secili mundet me dhanë dëshminë e vet, ai Zijadin Hoxha,  
23 apo kush është kanë, a ka shku apo nuk ka shku ai. Unë për  
24 vete personalisht nuk kam marrë pjesë.

25 PY. Faleminderit, z. Gashi.

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 99

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1           Z. Gashi, tani dua që të kthehem tek dokumenti që u shfaq  
2 në ekran ma herët, që kishte të bëjë me operacionet në vitin  
3 1999.

4           ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Znj. Gjykatëse, në qoftë se mund  
5 të shfaqim dokumentin me numër 4 nga lista e materialeve.

6           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me --  
7 cili është qëllimi?

8           ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Për të bërë disa pyetje në  
9 lidhje me afatet kohore. Ndoshta përpara se të shfaqim  
10 dokumentin, mund t'i bëj dëshmitarit edhe disa pyetje shtesë.

11          PY. Z. Gashi, sot na thatë që komandanti i Brigadës 128 ishte  
12 Ruzhdi Saramati.

13          PË. E saktë.

14          PY. Gjithashtu thatë që jeni taku me të --

15          PË. Po.

16          PY. -- nja dy herë gjatë kohës që ke qenë në luftë, a është  
17 saktë?

18          PË. Ndoshta, dy-tri herë thashë. Më duket ashtu e kam thanë  
19 edhe, jo dy herë, por dy-tri herë.

20          PY. A u takove me të në momentin kur u kyçe, që thatë në  
21 mars, a ka qenë kjo një prej rasteve dhe kur jeni taku me të?

22          PË. Para po, kur jem kyçë në UÇK, ekzakt. Edhe nja dy herë  
23 apo tri, mos gabofsha, jemi pa në, domethënë, në vija të  
24 frontit.

25          PY. Pra, herën e parë jeni taku në shtëpinë në Kukës, në atë

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 100

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 shtëpinë në Kukës, a është e saktë?

2 PË. Aty ku fola, e saktë. Aty veç një herë jam taku, kam  
3 dhanë emnin, mbiemnin dhe betimin.

4 PY. A të kujtohen ato herët e tjera kur e ke taku në vijën e  
5 frontit, kur, nëse ju kujtohet koha?

6 PË. Koha më kujtohet, një herë kah na ka pasë mbajtë si një  
7 mbledhje për, domethënë, për ushtarë. Edhe një herë apo dy,  
8 domethënë, gjatë përfundimit të luftës. Veç një si kish hi  
9 KFOR-i na ka pasë mbajtë edhe një farë mbledhje. Mos me  
10 shkrepë fishekë pa lidhje, mos me harxhitë, këto sende janë  
11 kanë.

12 PY. Pra, në momentin kur ka ardhë dhe ka ba takimin në lidhje  
13 me ushtarët, a mund ta përshkruani për çka ishte ky takim, kjo  
14 mbledhje?

15 PË. Jo, takim i thjeshtë, normal me na sugjeru, si me vepru  
16 ndaj forcave serbe, kështu me radhë. Tjetër informacion s'ka  
17 pasë.

18 PY. Pra, ky takim u mbajt gjatë luftimeve, se kanë ndodhë,  
19 ishin duke ndodhë luftime, ju ka dhanë udhëzime për luftimet,  
20 e kështu me radhë?

21 PË. Ashtu. Herë pas here, nuk ka pasë, domethënë, non-stop  
22 luftime, ka pasë edhe armëpushim, po ki një orë apo dy orë,  
23 apo tri, ashtu. Ashtu është.

24 PY. Që ta konfirmojmë, ku, në cilin vend u bë ky takim?

25 PË. Në Gorozhup. Afër kufirit.

1 PY. Z. Gashi, po jua bëj këtë pyetje për Ruzhdi Saramatin  
2 sepse kemi materiale provash në këtë çështje që tregojnë se  
3 Ruzhdi Saramati në fakt ka ardhë në Gorozhup vetëm pas datës  
4 24 maj 1999 kur ka marrë drejtimin e operacionit të tretë,  
5 domethënë, në kuadër të Operacionit Shigjeta.

6 A mund të na shpjegoni se si keni mujtë me u taku me të  
7 përpara kësaj date?

8 PË. Më fal, edhe një herë pyetjen? Mundësisht.

9 PY. Natyrisht. Ne kemi prova në këtë çështje gjyqësore që  
10 tregojnë se Ruzhdi Saramati ka shku në Gorozhup vetëm pas  
11 datës 20 maj 1999. Dhe që e ka ba këtë në kuadër të një  
12 operacioni konkret që është Operacioni Shigjeta. A ke ndëgju  
13 ndonjëherë për Operacionin Shigjeta?

14 PË. Po. Pseudonimin e ka pasë, domethënë, Brigada 128,  
15 Shigjeta. Unë tash datat e sakta nuk më kujtohen, por një herë  
16 ka ardhë në Gorozhup edhe një herë kam folë, tregova kur jam  
17 rregjistruar në Kukës me Ruzhdinë. Por ka pasë raste se ka pasë  
18 edhe dy herë që jemi pa gjatë luftimeve me Ruzhdinë. A datat e  
19 saktat, nuk më kujtohen.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
21 Prokurore, keni edhe pesë minuta përpara se të bëjmë pushimin  
22 e shkurtër.

23 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

24 Z. Avokat, e keni fjalën ju.

25 Z. AOUINI: [Përkthim]

1 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ne do të kërkojmë referenca  
2 konkrete të materialeve të provave që u sugjeruan. Dhe sipas  
3 konfirmimeve nga kolegët tanë, kjo pretendimi që ky personi ka  
4 shku atje në këtë datë për herë të parë dhe që s'ka qenë më  
5 parë.

6 Duket që ka një mospërputhje, sepse kemi një datë  
7 konkrete të kësaj, veç kemi data të tjera. Pra në të dyja anët  
8 duhet të kemi qartësi.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
10 Prokurore, shoh që ju po pohoni me kokë se do të jepni  
11 referencat në fjalë.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po. Në fakt disa prej  
13 referencave janë dokumente që do të doja t'i shfaq edhe për  
14 dëshmitarin. Nuk, ndoshta s'është momenti i duhur ta bëjmë  
15 këtë sepse kemi pushimin pas pak minutash dhe të mos ndërpres  
16 rrjedhën e pyetjeve, në qoftë se kjo bëhet.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do  
18 vazhdojmë në këtë mënyrë atëherë. Natyrisht kemi edhe nesër.

19 A mund të na tregoni edhe sa kohë do t'ju duhet juve  
20 sipas vlerësimit tuaj për të marrë në pyetje këtë dëshmitar?  
21 Për të përfunduar marrjen në pyetje?

22 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Besoj që do të më duhet edhe një  
23 gjysmë ore. Megjithatë do të doja që të bënim pushimin që të  
24 bëj një rivlerësim të pyetjeve tona, dhe t'ju jap një vlerësim  
25 më të saktë pastaj.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
2 rregull.

3 Z. Avokat, i drejtohem i tani Mbrojtësit të Viktimave,  
4 keni një vlerësim të kohës që do t'ju duhet për të bërë  
5 pyetje?

6 Z. LAWS: [Përkthim] Kam disa pyetje. Tani a do të bëhen  
7 këto pyetje nga Prokuroria përpara se të marr fjalën, nuk e  
8 di, duhet të shohim.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
10 Avokat i Mbrojtjes keni diçka për të thënë?

11 Z. AOUINI: [Përkthim] Që të konstatohet në procesverbal,  
12 përdorimi i publikimeve në Facebook, publikimet e një personi  
13 tjetër, duam të shënohet në procesverbal se ne shprehim të  
14 gjitha rezervat tona për peshën që mund t'u jepet këtyre  
15 publikimeve në Facebook. Edhe pse tema për të cilën diskutohet  
16 është e rëndësishme.

17 Dhe po ashtu, statusi i materialeve të provave të cilat u  
18 referuan, janë prova të dyshimta, duhet edhe të merren  
19 parasysh lidhur me peshën që do t'u jepet, rëndësinë që do t'u  
20 jepet këtyre provave. Ne nuk e kemi dëshmitarin në fjalë këtu  
21 për ta marrë në pyetje. Pra, të gjitha këto duhet të merren  
22 parasysh dhe deshëm që kjo të jetë në procesverbal.

23 Faleminderit, znj. Gjykatëse.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit, z. Avokat.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 Tani do të bëjmë një pushim të shkurtër 15 minuta.

2 Znj. Asistente, ju lutem, shoqëroni dëshmitarin jashtë  
3 sallës së gjyqit, do kthehemi pas 15 minutash. Faleminderit.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit. Seanca ndërpritet deri në orën 15.30.

7 --- Pauza fillon në orën 15.14

8 --- Seanca rifillon në orën 15.33

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
10 se ju gjej. Z. Shala është me neve.

11 A më dëgjoni mirë, z. Shala?

12 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj mirë,  
13 faleminderit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit.

16 Konstatoj se prania e palëve është e njëjtë si më parë.

17 Atëherë, vazhdojmë me marrjen në pyetje të dëshmitarit të  
18 Mbrojtjes nga Prokuroria. A mund të na thuani sa kohë ju duhet  
19 akoma?

20 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Do të na duhen 45 minuta,  
21 ndoshta dhe pak më shumë. Do përpiqem që t'i trajtoj temat që  
22 kam për të trajtuar sot, përndryshe mund të vazhdojmë pak edhe  
23 nesër.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do  
25 vazhdojmë edhe nesër. Që ta dini, nesër do të japim disa



Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 105

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 urdhra gojorë lidhur me procesin këtu.

2 Znj. Asistente, mund të sillni dëshmitarin në sallë tani.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

5 se ju vini, z. Dëshmitar. Keni edhe pak durim me ne. Do

6 vazhdojmë deri në orën 16.00, pastaj do rifillojmë nesër në

7 mëngjes.

8 Tani do t'ia kaloj fjalën znj. Prokurore.

9 Z. Shala, nuk mund t'ju pyes tani nëse e dëgjoni

10 dëshmitarin, por kur të fillojë të flasë në qoftë se nuk e

11 dëgjoni, ngritni dorën ju lutem.

12 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, kuptova.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

14 rregull.

15 Znj. Prokurore, fjalën e keni ju.

16 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

17 PY. Atëherë, z. Gashi, gjatë kohës që keni qëndru në

18 Gorozhup, a jeni largu ndonjëherë nga vijat e frontit, nga

19 vija e frontit, për të shku diku tjetër?

20 PË. Unë personalisht, jo.

21 PY. Pra, nuk jeni largu për asnjë arsye?

22 PË. Jo, kam pasë lëvizje, domethënë, lëvizje prej fshatrave

23 nëpër fshatra me shku, me kontrollu, ama tjetër kah jo. Aty në

24 rrethinë, po.

25 PY. Faleminderit.

1 PË. Njësia juaj, a është largu ndonjëherë nga vija e frontit?

2 E kam fjalën për njësinë speciale për të cilën folët më herët.

3 PY. Jo, jo.

4 PË. Po ju bëj këto pyetje z. Gashi, sepse kemi dëgju prova,

5 dëshmi, në këtë çështje gjyqësore lidhur me disa ngjarje dhe

6 dua t'ju ballafaqoj me këto. Pak ma herët, po flisnim për

7 logjistikën, dhe siç e përmenda, ne kemi patur një dëshmitar

8 të Mbrojtjes këtu, Mark Shalaj, i cili ka qenë shefi i

9 logjistikës për Operacionin Shigjeta.

10 Mark Shalaj dëshmoi se Ruzhdi Saramati, që ju thatë ka

11 qenë komandant i Brigadës 128, pra që Ruzhdi Saramati ka shku

12 në vijën e frontit në drejtim të Gorozhupit, diku pas datës 20

13 maj 1999.

14 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Dhe për nevojat e palëve, kjo

15 dëshmi u dha në seancën e 23 tetorit, transkripti faqja 2990

16 deri në 3001.

17 PY. Mark Shalaj sqaroi se lëvizja e grupit të Saramatit në

18 Gorozhup, pas 20 majit, datës 20 maj, ishte sepse kishte grupe

19 tashmë që ishin në front ma herët, ishte se luftimet e

20 Operacionit Shigjeta, jo -- në të gjitha drejtimet e tjera,

21 por jo në drejtim të Koshares. Këto luftime kanë filluar vetëm

22 në fund të majit 1999.

23 Atëherë, z. Gashi, unë po ju them se, se në fakt në

24 Gorozhup nuk ka patur luftime përpara datës 20 maj 1999, apo

25 ka patur?

1 PË. Ka pasur.

2 PY. Mark Shalaj ka qenë shefi i logjistikës për Operacionin  
3 Shigjeta dhe me sa duket ka pasë shumë njohuri për këtë  
4 operacion. Ka udhëtu në vende të ndryshme, në qendra trajnimi,  
5 ushtrimesh, në vijat e frontit, ka qenë në Koshare, dhe kjo  
6 gjendet në transkriptin e datës 26 tetor 2023, faqja 2 -- 1348  
7 [Sipas përkthimit] dhe që luftimet në Koshare kanë fillu, në  
8 drejtim të koshares, kanë fillu në prill të 1999, por që në  
9 drejtimet e tjera ka fillu në fund, luftimet kanë fillu në  
10 fund të majit.

11 Si e shpjegoni ju këtë që ai na ka thënë që këto luftime  
12 kanë fillu vetëm në këtë kohë?

13 PË. Secili mundet me thanë mendjen e vet. Dikush mundet me  
14 ardhë me thanë se ban vaki kanë fillu edhe në qershor, në  
15 fund, si ka hi NATO. Por luftime ka pasë prej marsit 1999, në  
16 Pashtrik, luftime ka pasë.

17 PY. Z. Gashi, po ju them këtë sepse nuk është vetëm Mark  
18 Shala që e thotë këtë. Pra, që luftimet në drejtim të  
19 Gorozhupit kanë fillu vetëm në fund të majit. Në fakt, edhe ju  
20 vetë keni shku në Gorozhup vetëm mbas datës 20 maj, dhe se  
21 përpara kësaj date keni qenë në Kukës në fakt. A është kështu?  
22 A s'është kështu?

23 PË. Në Kukës, nuk jam kanë. Të thashë edhe ma herët. Në Kukës  
24 nuk jam kanë. Jam kanë në Kalimash. Në Kukës nuk jam kanë.

25 PY. Z. Gashi, sot përmendët, folët për njësinë speciale dhe

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 108

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 thatë që kanë qenë 11 deri në 15 pjesëtarë.

2 PË. Po.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

5 z. Avokat, keni fjalën.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do të doja që t'i paraqitet z.

7 Dëshmitar deklarata e z. Shalaj, sepse z. Shalaj po flet për

8 Operacionin --

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Prisni një çast përpara se të flisni për përmbajtjen e

11 deklaratës, duhet që dëshmitarit të shoqërohet jashtë sallës

12 së gjyqit.

13 Z. Dëshmitar, do t'ju shoqërojmë jashtë sallë së gjyqit,

14 me qëllim që të bisedojmë, të diskutojmë disa çështje që kanë

15 të bëjnë me pyetjet që do t'ju bëhen.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do

18 t'ju jap fjalën z. Avokat Mbrojtës, pastaj do të kthehem tek

19 zonja, do t'i drejtohem znj. Prokurore lidhur me mënyrën sesi

20 Prokuroria duhet të paraqesë provat e saj para dëshmitarit.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dua që të jem i sigurt që

22 dëshmitarit t'i jepen informacione të drejta. Sipas mendimit

23 tim, z. Mark Shalaj po fliste për Operacionin Shigjeta në maj,

24 por ai nuk tha asnjë herë që përpara Operacionit Shigjeta nuk

25 ka patur luftime.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 Nuk e di ku vjen, nga ku vjen ky informacion dhe do të  
2 doja ta shihja cili, në cilin dokument, apo në cilën deklaratë  
3 z. Mark Shalaj thotë, apo cilin dokument apo deklaratë e Mark  
4 Shalës po përdor Prokuroria tani.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,  
6 nuk është që doni që t'ia tregoni këtë deklaratë dëshmitarit,  
7 por dëshironi të dini, të njihni burimin e informacionit të  
8 cilin po përdor Prokuroria.

9 Znj. Prokurore, a mund të jepni referencat dhe, në qoftë  
10 se keni dokumentin përpara jush, mund edhe të na lexoni neve  
11 të gjithëve.

12 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, znj. Gjykatëse. Referenca  
13 është ajo që dhashë më parë, megjithatë po e përsëris. Është  
14 transkripti i datës 25 tetor 2023, faqja 3141, dhe fillon në  
15 rreshtin 6 ose 9, mund t'ju lexoj në rreshtin 9. Pyetje nga  
16 Gjykatësi Bitti:

17 "Nga ajo që kuptojmë ne që jeni takuar në prill..."

18 Po flasim për --

19 "...pastaj ka shku në front dhe pse, a mund të sqaroni se  
20 pse Operacioni Shigjeta nuk ka pasë filluar në prill? A mund  
21 ta sqaroni?"

22 Përgjigjja:

23 "Jo, Operacioni Shigjeta ka filluar në maj."

24 Pra, Gjykatësi Bitti, vazhdon thotë:

25 "Nuk ka shkuar të marrë pjesë aty sepse në Operacionin

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 Shigjeta, sepse Shigjeta ka filluar në maj.”

2 Përgjigja e Mark Shalës:

3 “Njësitë tona kanë qenë në pozicion vazhdimisht edhe pse  
4 luftimet e vetë Operacionit Shigjeta kanë filluar në maj. Pra  
5 ka qenë në këtë pozicion që nga fillimi i mbërritjes së tij  
6 aty.”

7 Pastaj vazhdon më tej në faqen vijuese, faqja 5:

8 “Pyetja ime është sipas jush, me sa dini ju, a ka patur  
9 ushtarë në front të pozicionuar aty dhe a ka patur luftime  
10 përpara fillimit zyrtar të Operacionit?

11 Përgjigje:

12 “Po, në një drejtim, po.

13 “PY. A mund të na ndihmoni në cilin drejtim, apo në  
14 cilën zonë në përgjithësi?

15 “PË. Kjo ka qenë në drejtim të Koshares. Kemi filluar  
16 shumë më herët, dhe mendoj që ka qenë në prill. Luftimet  
17 kishin filluar aty më herët, kanë filluar më 9 ose më 10  
18 prill.

19 “Ndërsa në drejtimet e tjera, disa aty kishin shkuar në  
20 pozicione të tyre, por nuk ka patur luftime të drejtpërdrejta  
21 deri në fillimin e operacionit. Pra ishin në fazë përgatitore  
22 duke u pozicionuar, disa ishin duke u pozicionuar, disa të  
23 tjerë po bënë ushtrime stërvitje për t’u përgatitur për  
24 Operacionin Shigjeta.”

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 Avokat, cili është qëndrimi juaj lidhur me këtë?

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ne kemi të njëjtin burim dhe po  
3 lexoj dokumentin që kam në dorë dhe mendoj që, unë parashtrova  
4 se z. Mark Shalaj po fliste për Operacionin Shigjeta. Kjo nuk  
5 do të thotë që nuk ka patur kontakte luftimesh mes serbëve dhe  
6 UÇK-së, qoftë në mars apo në prill, përpara, pak orë përpara  
7 Operacionit Shigjeta. Pra, mendoj se nuk mund të  
8 përgjithësohemi në informacionet e dhëna për Operacionin  
9 Shigjeta dhe t'i zbatojmë këto për të gjitha luftimet apo  
10 kontekstin që ishte përpara Operacionit Shigjeta. E dimë që ka  
11 patur luftime të ashpra përpara, në të cilat vetë z. Shala  
12 është plagosur. Pra do t'i tregojmë kujdes që të kemi një  
13 interpretim rigoroz të asaj që thuhet, pra kur Mark Shalaj  
14 flet vetëm për përfshirjen e tij në Operacionin Shigjeta.

15 Dhe të jemi të kujdesshëm për këtë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
17 Prokurore, keni diçka për të shtuar lidhur me këtë?

18 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, thjesht do them që z. Mark  
19 Shalaj ka dhënë dëshminë shumë të qartë dhe kemi të drejtë që  
20 ta eksplorojmë këtë. Mark Shalaj nuk po fliste vetëm për këtë  
21 operacion konkretisht, por fliste në mënyrë të gjerë për  
22 përgatitje për këtë operacion dhe tha që luftimet në Koshare  
23 kanë filluar në prill, por në drejtimet e tjera nuk ka patur  
24 luftime gjatë kohës që ai ka qenë aty. Ne e dimë që ai ka qenë  
25 aty që nga fillimi i prillit. Ishte shefi, eprori i lartë për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 112

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 logjistikën dhe i dinte këto gjëra. Kjo është konteksti në të  
2 cilin ne besojmë që mund t'i paraqesim këto gjëra dëshmitarit,  
3 dhe të kërkojmë reagimin e tij në lidhje me këtë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni  
5 diçka për të shtuar, z. Mbrojtësi i Viktimave?

6 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
8 të vazhdoni për aq kohë që ia bëni të qartë dëshmitarit që  
9 këto janë thënë në deklaratat e z. Mark Shalaj, dhe të njëjtën  
10 po ashtu kur i thoni dëshmitarit, "ju paraqes", "ju  
11 ballafaqoj", dua që ju ta bëni më të qartë qëndrimin tuaj si  
12 Zyrë e Prokurorit të Specializuar se mendimi, qëndrimi, a  
13 vlerësimi juaj është që ai nuk ka qenë aty, sepse nuk dua që  
14 të ketë paqartësi në këtë aspekt.

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Do të veprojmë kështu znj.  
16 Gjykatëse, natyrisht.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
18 Atëherë do vazhdojmë.

19 Znj. Sekretare, a mund t'i kërkonim znj. Asistente që të  
20 sjellë dëshmitarin në zyrë [Sipas përkthimit] përsëri?

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
23 se u kthyet, z. Dëshmitar.

24 DËSHMITARI: Faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do



Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 113

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 t'ia jap fjalën tani znj. Prokurore, edhe dhjetë minuta kemi  
2 përpara se ta mbyllim sot.

3 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim]

4 PY. Z. Gashi, sot na thatë se nuk jeni larguar kurrë prej  
5 frontit, dhe se njësia jua nuk u largua prej frontit. A e  
6 njihni dikën të quajtur Idajet Gashi, me nofkën Xhiga ose  
7 Giga?

8 PË. Po.

9 PY. Kush është ai?

10 PË. Është ushtar, është i Prizrenit, qytetit tim.

11 PY. Ka qenë dhe ky i përfshirë në luftë me ju?

12 PË. Me mue nuk është kanë.

13 PY. Po në cilën njësi ishte anëtar ai, e dini?

14 PË. Nuk e di.

15 PY. Jeni taku ndonjëherë me të gjatë lufte?

16 PË. Po, një herë, po.

17 PY. Ku?

18 PË. Kështu e kam pa, gjatë luftimeve jo, por ka pasë,

19 domethënë, s'ka pasë luftime, atë ditë jemi taku, po.

20 PY. Po ku ka ndodhur ky takim?

21 PË. Në Gorozhup. Afër Gorozhupit, afër Shqipërisë, me një

22 fshat.

23 PY. Datën, për afërsisht me kohë, a mund të na e thoni se kur?

24 PË. Jo, nuk më kujtohet.

25 PY. Mbase për afërsisht nga fillimi i përfshirjes tuaj në UÇK,

1 apo nga fundi a nga mesi?

2 PË. Përafërsisht mundet me kanë mesi. Mesi, fillimi i luftës  
3 jo. Kah mesi aty.

4 PY. Pak a shumë cili muaj mund të ketë qenë, afërsisht?

5 PË. Nuk më kujtohet, për nder.

6 PY. Z. Gashi, kemi këtu material provues që tregon se Idajet  
7 Gashi ishte gjithashtu ushtar në Brigadën 128, nën komandën e  
8 Saramatit. Luftonte edhe ai në Gorozhup, dhe ishte anëtar i  
9 njësitit të Valbon Çollakut, përgjegjësia, kishte si  
10 përgjegjësi që të pastronte si të thuash, të pastronte frontin  
11 për njësitet e tjera që të ecnin njësitet e tjera.

12 Idajet Gashi është kyçur për herë të parë në UÇK në mars  
13 apo në prill 1999 në Kukës, në ofiçinën, pra në uzinën  
14 metalike të Kukësit.

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Dhe mund ta jap referencën për  
16 këtë, për Trupin Gjykues që është numër ERN-je 065236-TR-ET  
17 Pjesa 2, RED, faqja 7, rreshti 9; faqja 9, rreshtat 13 deri në  
18 15; faqja 18, rreshtat 21 deri 25; dhe faqja 19, rreshtat 1  
19 deri 3.

20 PY. Kemi informacion se pas regjistrimit, pra kyçjes, në  
21 uzinën metalike të Kukësit, Idajet Gashi është, e ka krye  
22 stërvitjen në Kalimash dhe pas disa dislokimeve --

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
24 Faleminderit, shoh që z. Avokat i Mbrojtjes është ngritur në  
25 këmbë.

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 115

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 Keni fjalën, z. Avokat. Keni nevojë që ta nxjerrim  
2 dëshmitarin nga salla apo jo?

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, nuk mendoj. Ka të bëjë për  
4 referencat. Këtu janë marrë shumë referenca. Duket se flasin  
5 për Nashecin, jo për Kukësin. Duam të dimë se cila prej këtyre  
6 referencave bën fjalë për Kukësin në këtë moment, ju lutem?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
8 Dëshmitar.

9 DËSHMITARI: Znj. Prokurore ma ban pyetjen dhe nuk len me  
10 ba përgjigjen unë. Më tha se a e njofësh Gigën, apo si e pat  
11 pseudonimin ai. Si e pati pseudonimin ai person. Ai sa e njof  
12 unë, nuk është kanë në togun tim. Këtë e pata veç me të drejtë  
13 me thanë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
15 Faleminderit, z. Dëshmitar.

16 Znj. Prokurore, mund t'i përgjigjeni pyetjes së z. Avokat  
17 të Mbrojtjes?

18 Dhe mos harrojmë që jemi thujse në fund të seancës sot.

19 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse, disa  
20 referenca të tjera janë faqja 30, rreshti 13, deri në faqen  
21 32, rreshti 24. Dhe është dhe faqja 20, rreshtat 17 deri 18;  
22 faqja 22, rreshtat 8 deri 21; faqja 4, rreshtat 19 deri 20.

23 Besoj se të gjitha këto mbulojnë temat për të cilat po i bëj  
24 pyetje dëshmitarit tani.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por,

Dëshmitari: Safet Gashi (Seancë e hapur)

Faqe 116

Pyetje të palës tjetër nga znj. Pergolo

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 me sa kuptova unë, është që, z. Avokat, ju po kërkonit një  
2 referencë konkrete për Kukësin, mirëpo me sa duket është një  
3 temë më e gjerë që po mbulon Prokuroria.

4 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse, ky është  
5 problemi. Sepse tani po flasim për mobilizimin në Kukës për  
6 këtë individ në fjalë. Ndërkohë që këtu morëm një mori  
7 referencash që shkojnë nga Gorozhupi deri në Nashec deri në  
8 Kukës. Ky nuk është dëshmitari i çështjes tonë. Nuk e dimë  
9 nëse ky person çfarë ka thënë ky person, nëse ka qenë apo jo  
10 në të njëjtin batalion, në atë kohë, më pas. Ky s'është  
11 dëshmitari ynë, nuk mund ta testojmë. Pra, nuk e dimë shumë  
12 gjëra për këtë, janë vetëm disa rreshta këtu dhe atje.

13 Shohim për shembull në faqen 20, së paku, referenca e  
14 fundit që kapa, faqja 20 është referencë, pra përmend që ky  
15 individ është kyçur fillimisht, është regjistruar fillimisht  
16 në Kukës.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
18 kemi dëshmitarin këtu, nëse do të citoni, atëherë nuk mund ta  
19 diskutojmë këtë gjë përpara dëshmitarit. Por mendoj se na ka  
20 mbaruar koha për sot.

21 Z. Dëshmitar, do ta vijojmë dëshminë tuaj nesër. Ju  
22 falënderoj shumë për dhënien e dëshmisë sot. Ju rikujtoj se  
23 nuk duhet të diskutoni me askënd për ato çfarë keni thënë  
24 këtu, në sallë. Shihemi sërish nesër, shpresoj të keni  
25 mundësinë të pushoni sonte. Faleminderit.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1           Znj. Asistente --

2           DËSHMITARI: Faleminderit.

3           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] -- do  
4 t'ju shoqërojë që të dilni nga salla.

5                           [Dëshmitari përfundon dëshminë]

6           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

7 Avokat, cila është kërkesa juaj konkrete për Prokurorinë për  
8 nesër? Të shikoj se çfarë mund të them, çfarë vendimi të  
9 marrim nëse ka nevojë.

10          Z. AOUINI: [Përkthim] Për secilin material provues, duke  
11 qenë se është kundërshtuar, është rrëzuar kundërshtimi im,  
12 është që ato të japin referencën specifike si bazë e pyetjes.  
13 Ky individ është regjistruar në Kukës, tani po e kuptojmë. Por  
14 kemi marrë një mori referencash që s'na ndihmojnë, nuk na  
15 lejojnë që ta ndjekim këtë çështje.

16          Por, në të njëjtën faqe për shembull shohim se ky person  
17 ka marrë pjesë në dy brigada, përmend pesë a gjashtë vende ku  
18 ka qenë, me sa duket ishte për një periudhë një muaj e gjysmë  
19 në front, në Gorozhup. Dhe mbase na duhet diçka më shumë për  
20 të qenë në gjendje për ta ndjekur në fakt. Ky është me sa  
21 duket problemi, përdorimi i këtyre deklaratave.

22          KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ngaqë  
23 e kemi rrëzuar kundërshtimin tuaj, por besoj se Prokuroria do  
24 ta marrë parasysh këtë që për pyetje specifike të japë  
25 referenca specifike. Besoj se ky nuk do të jetë problem nesër.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.*

1 Në rregull atëherë. Do ta mbyllim këtu, por përpara se të  
2 bëjmë ndërprerjen e seancës sot, a ka ndonjë gjë tjetër që  
3 Zyra e Prokurorit të Specializuar dëshiron të ngrejë si  
4 çështje sot?

5 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
7 Faleminderit.

8 Mbrojtësi i Viktimave?

9 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
11 Avokati i Mbrojtjes?

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, faleminderit shumë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,  
14 në rregull.

15 Do ta vijojmë seancën nesër, ju uroj mbrëmje të mirë.  
16 Këtu bëjmë ndërprerjen për sot.

17 --- Seanca mbyllet në orën 16.01

18

19

20

21

22

23

24

25